

Mësoni gjermanisht në qarkun Düren Ne ju këshillojmë me kënaqësi!

Bëjeni jetën më të lehtë, mësoni gjermanisht!

Nëse e zotëroni gjuhën gjermane, mund të gjeni punë më shpejt, të mbështesni më mirë fëmijët tuaj dhe të orientoheni më mirë në Gjermani. Ju gjithashtu mund t'i perceptoni më mirë të drejtat tuaja në këtë vend.

Në qarkun Düren keni mundësi të ndryshme për të mësuar gjermanisht. Në fletë informative ju gjeni të gjitha adresat e qendrave të këshillimit dhe informacione që mbështesin emigrantët në qarkun Düren me këshilla dhe vepra.

Në faqen zyrtare të internetit të qendrës komunale të integrimit gjeni të gjitha adresat të ofruesve aktivë të kurseve të gjuhës.

Kush mund të marrë pjesë në kursin e integrimit?

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për emigracionin më 1 janar 2005, të huajt që emigrojnë legalisht në Gjermani dhe nuk kanë të paktën një njohuri të thjeshtë të gjermanishtes duhet të ndjekin një kurs integrimi (pjesëmarrja për qytetarët e BE-së dhe të riatdhesuarit është fakultative). Përveç kësaj, ju mund të merrni pjesë vullnetarisht nëse jetoni në mënyrë të ligjshme në Gjermani dhe flisni pak ose aspak gjermanisht.

Çfarë është kursi i integrimit?

Ai përbëhet nga 600-900 orë mësimi në gjuhën gjermane dhe 100 orë informacione rreth politikës dhe sistemit shoqëror në Gjermani.

Në fund të kursit të integrimit bëhet një provim gjuhe sipas standardit evropian (Zertifikat Deutsch - Niveli B1).

Sa kushton kursi i integrimit?

Një kurs integrimi kushton 1,95 euro për orë.

Nëse jeni i papunë ose fitoni pak para, ndoshta mund ta ndiqni kursin edhe falas. Për këtë, informohuni nga një prej pikave të këshillimit të përmendura më poshtë.

Çfarë avantazhesh mund të shfrytëzoni?

Nëse e mbaroni me sukses provimin e gjuhës, mund të merrni shtetësinë gjermane pas 7 vjetësh të qëndrimit të ligjshëm dhe nuk do të keni nevojë për një provim tjetër të gjuhës.

Kush mund të detyrohet për ndjekjen e kursit?

Autoritetet e të huajve ose qendrat e punës mund t'ju detyrojnë të merrni pjesë në një kurs të gjermanishtes nëse merrni paratë e papunësisë II (Arbeitslosengeld II) dhe keni më shumë shanse të gjeni një punë me njohuri më të mira të gjermanishtes ose nëse flisni pak gjermanisht dhe prandaj nuk mund t'i mbështetni fëmijët tuaj.

Çfarë disavantazhesh mund të keni nëse nuk e ndiqni kursin e integritit?

Leja e qëndrimit mund t'ju lëshohet për kohëzgjatje të shkurtra. Ju nuk merrni leje qëndrimi të përhershme (Niederlassungserlaubnis), pra të drejtë të papërcaktuar qëndrimi në Gjermani, nëse nuk e zotëroni mjaftueshëm gjuhën gjermane. Edhe nëse dëshironi të merrni nënshtetësinë ju duhet të jeni në gjendje ta flisni dhe lexoni mjaftueshëm gjuhën gjermane.

Informacione të mëtejshme i gjeni në www.bamf.de

Këshillim dhe informacione merrni këtu:

Oferta këshillimi	Institucioni/adresa	Kontakti
Beratung für Arbeitssuchende	Agentur für Arbeit Düren Moltkestr. 49, 52351 Düren	0241 897 1111 Aachen-dueren.integration- point@arbeitsagentur.de
Flüchtlings- und Migrationsberatung	Caritasverband für die Region Düren-Jülich e.V. Kurfürstenstr. 10-12 52351 Düren	02421 48145, 0241 48147 bkorn@gst.caritas-dn.de ageerken@gst.caritas-dn.de
Flüchtlingsberatung für den Nordkreis	Diakonisches Werk des Kirchenkreises Jülich Schirmerstr. 1a 52428 Jülich	02461 975614 luedeke@diakonie-juelich.de
Café International Zentrum für Sozial- und Migrationsberatung	Ev. Gemeinde zu Düren Wilhelm-Wester-Weg 1 52349 Düren	02421 188187 hava.zaimi@evangelische- -gemeinde-dueren.de
SGB-II – Beratung (Arbeitslosengeld II)	Kreisverwaltung Düren job-com Bismarckstr. 10 52351 Düren	02421 22 17042 c.muschenich@kreis-dueren.de
Ausländerbehörde Kreis Düren	Kreisverwaltung Düren Bismarckstr. 16 52351 Düren	02421 22 2135 abh@kreis-dueren.de
Schulberatung Kommunales Integrationszentrum	Kreisverwaltung Düren Bismarckstr. 16 52351 Düren	02421 22 1046110 ki-sekretariat@kreis-dueren.de
Jugendmigrationsdienst	SKF Düren Friedrichstr. 16 52351 Düren	02421 28430 spitz-venrath@skf-dueren.de

Ofertën e plotë të kurseve në qarkun Düren e gjeni në:

<https://www.kreis-dueren.de/kreishaus/amt/amt46/ki/Deutsch-lernen.php>

ose në faqen e internetit të Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatë (BAMF):

<https://bamf-navi.bamf.de/de/Themen/Integrationskurse/>